



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Infrastruktura e Cilësisë në Republikën e Kosovës



Infrastruktura e Cilësisë dhe Komponentët e saj

Përmes kësaj broshure informative shpjegohet struktura organizative e Infrastrukturës së Cilësisë në vendin tonë që është esenciale në zhvillimin e ekonomisë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në kuadër të Departamentit të Industrisë ka funksionalizuar Divizionin - Infrastruktura e Cilësisë. Në këtë kontekst, funksionalizimi i Infrastrukturës së Cilësisë ka synim ngritjen e vetëdijes mbi të gjitha fushat që mbulohen në kuadër të Infrastrukturës së Cilësisë dhe rëndësisë së tyre. Për më tepër, ngritja e vetëdijes për atë se si të gjitha palët e përfshira në Infrastrukturë të Cilësisë të punojnë së bashku në koordinimin e aktiviteteve për të përkrahur zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e konsumatorit në Republikën e Kosovës. Kjo iniciativë ka një shtrirje horizontale duke mundësuar inkorporimin proaktiv të të gjitha palëve të përfshira në Infrastrukturën e Cilësisë për avancimin e përgjithshëm cilësor të mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Kosovës.

Komponentët e Infrastrukturës së Cilësisë

- Standardizimi
- Akreditimi
- Metrologjia
- Mbikëqyrja e tregut
- Mbrojtja e konsumatorit
- Vlerësimi i konformitetit



Infrastruktura e Cilësisë është një përmbledhje e organizatave shtetërore ose private, të rregulluara në bazë të fushave përkatëse, aktivitetet e të cilave lidhen me përgatitjen dhe miratimin e standardeve dhe lëshimin e dëshmisë së konformitetit në:

- Përmirësimin e **përshtatshmërisë së produkteve** / shërbimeve,
- **Proceset dhe sistemet për qëllimin e synuar të tyre,**
- Parandalimin e **barrierave ndaj tregtisë** dhe lehtësimin në **bashkëpunim teknologjik.**

Rëndësia e Infrastrukturës Kombëtare të Cilësisë buron nga nevoja për të siguruar që mallrat (shërbimet) në procesin prodhues të jenë konform standardeve evropiane, për të dhënë një cilësi të dallueshme në lehtësimin e tregtisë si dhe për të mbrojtur konsumatorët. **Qëllimi**

Forcimi i **Infrastrukturës së Cilësisë** për rritje të përsheptuar ekonomike, ku sigurohet furnizimi i mallrave me cilësi të lartë dhe të sigurtë, për të **përmirësuar konkurrueshmërinë, standardin e jetesës dhe cilësinë e jetës** së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Misioni

Forcimi i konkurrencës rajonale dhe globale të mallrave dhe shërbimeve të Republikës së Kosovës dhe kontribuimi drejt përmirësimit të cilësisë së jetesës të popullit të Kosovës, përmes përdorimit të kujdesshëm të standardeve, matjeve, vlerësimit të konformitetit dhe akreditimit.

Vizioni

Zhvillimi dhe forcimi i një infrastrukture të cilësisë efektive, të qëndrueshme dhe të njohur ndërkombëtarisht, duke kontribuar drejt arritjes së qëllimeve socio-ekonomike të Republikës së Kosovës.

Divizioni për Infrastrukturë të Cilësisë, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë:

- Propozon politika për ngritjen e infrastrukturës së cilësisë;
- Siguron harmonizimin e legjislacionit vendor për lëvizjen e lirë të mallrave me legjislacionin e BE-së;
- Përafron direktivat evropiane në fushën e legjislacionit teknik në sistemin legjislativ të Kosovës;
- Vlerëson zbatimin e rregullave teknike në fushën e sigurisë.

Objektivat e politikave të Infrastrukturës së Cilësisë

- Zhvillimi, zbatimi dhe mirëmbajtja e një infrastrukture moderne të cilësisë, të bazuar në parimet ndërkombëtare.
- Sigurimi i një baze për të lehtësuar tregtinë dhe për të promovuar investimet.
- Krijimi i një Infrastrukture Kombëtare të Cilësisë.
- Futja e konceptit të cilësisë përmes edukimit dhe trajnimit në të gjitha nivelet e shoqërisë.
- Ofrimi i mbështetjes në fushën e infrastrukturës së cilësisë për të gjitha industritë, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Drejtoria e Akreditimit të Kosovës



Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) është i vetmi Organ Kombëtar i Akreditimit, i njohur nga qeveria, për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit që kryejnë aktivitete të tilla si: testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim, qofshin në sektorët publikë apo privatë, të fushës vullnetare apo të detyrueshme. Deri më tani DAK ka të akredituara 26 Trupa për Vlerësimin e Konformitetit, prej tyre: tre (3) Trupa Inspektues (TI), 22 Laboratorë Testues (LT) dhe një Laborator Kalibruar (LK).

Fushëveprimtaria e Drejtorisë së Akreditimit është:

- Akreditimi i laboratorëve testues dhe kalibruar;
- Akreditimi i trupave certifikues të sistemeve të menaxhimit;
- Akreditimi i organizmave certifikues të personelit;
- Akreditimi i trupave certifikues të produkteve;



- Akreditimi i trupave certifikues të mbrojtjes së ambientit;
- Akreditimi i trupave inspektues.

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës ka këto përgjegjësi:

- këshillon administratën shtetërore për çështjet e akreditimit,
- mban evidencë për trupat e akredituar,
- kryen trajnime për fushën e akreditimit,
- vendos gjoba, subjekteve të cilat e keqpërdorin emblemën e akreditimi,
- trajton ankesat dhe aplikimet për akreditim,
- bashkëpunon me organizmat kombëtarë të akreditimit,
- përfaqëson Kosovën në organizmat evropianë dhe ndërkombëtarë.

Misioni i Drejtorisë së Akreditimit është që t’iu ofrojë të gjitha palëve të interesuara të laboratorëve testues dhe kalibruës, trupave inspektues si dhe trupave certifikues akreditimin në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligje, standarde dhe në parimet e akreditimit.

Vizioni i Drejtorisë së Akreditimit është që në një periudhë të afërt të jetë nënshkruese e marrëveshjes multilaterale, bilaterale (MLA, BLA) me EA-së (Korporata Evropiane e Akreditimit) në fushën e laboratorëve testues, njohjen e raporteve testuese nga EA.

Bashkëpunimi në nivelin evropian dhe ndërkombëtar i DAK-së

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës, bashkëpunon me të gjitha organizmat akreditues të vendeve të rajonit dhe atyre ndërkombëtare dhe po punon për institucionalizimin e këtij bashkëpunimi, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi:

1. Më 27 mars 2008, DAK nënshkroi MoU-en me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) të Republikës së Shqipërisë.
2. Më 14 maj 2009, DAK nënshkroi MoU-en me Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë (IARM)
3. Më 19 nëntor 2009, DAK nënshkroi MoU-en edhe me Agjencinë Turke të Akreditimit (TURKAK), të Republikës së Turqisë
4. Më 26 nëntor 2009, në Brugge të Belgjikës në Asamblenë Gjenerale të EA-së, DAK është anëtarësuar në EA (Europeanco-operation for Accreditation) si anëtare me Kontratë (Co-operation Member).
5. Më 17 qershor 2010, DAK në Bruksel të Belgjikës nënshkroi MoU-en me Agjencinë Kroate të Akreditimit (HAA), të Republikës së Kroacisë.

6. Më 27 korrik 2010, DAK është anëtarësuar në Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit të Laboratorëve ILAC (International Laboratory Accreditation Cooperation).
7. Më 2 gusht 2010, DAK është anëtarësuar në Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF) (International Accreditation Forum).
8. Më 24 nëntor 2011 në Varshavë të Polonisë, Drejtoria e Akreditimit e Kosovës u bë anëtare-shok (associate-member) me EA (Europeanco-operation for Accreditation).
9. Më 29 mars 2013, DAK arriti të nënshkruajë memorandum mirëkuptimit me Trupin Akreditues të Rumanisë RENAR (Romanian Accreditation Association).



Agjencia Kosovare për Standardizim

Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS) është organ kombëtar përgjegjës për udhëheqjen, organizimin dhe kontrollin e veprimtarisë së standardizimit në Kosovë.

Misioni

Agjencia Kosovare e Standardizimit është organ kombëtar që miraton standarde, i harmonizon ato, dhe si rezultat stimulon fuqishëm zhvillimin ekonomik, duke krijuar bazë për konkurrueshmëri në rajon dhe më gjerë.

Objektivat

- Të ndihmojë në mbrojtjen e qytetarëve nga rreziku i konsumit të përditshëm të produkteve të pakontrol luara dhe të pasigurta;
- Të ndihmojë në rritjen e konkurrencës në tregun vendor, ku si rezultat do të fitonim nxitjen e eksportit dhe uljen e importit;
- Të zvogëlojë barrierat teknike në tregti duke sjellë shtim të vëllimit të shkëmbimeve tregtare.

Përfitimet e Industrisë, duke punuar me standarde:

- Ulë koston e prodhimit,
- Jep efekte pozitive në komunikim ndërmjet sektorëve,
- Siguron nivele më të ulëta të aksidenteve në punë,
- Rritje e besueshmërisë në sigurinë e produkteve.

Agjencia e Metrologjisë së Kosovës

Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK), me laboratorët që posedon, kryen verifikimin, testimin dhe kalibrimin e mjeteve matëse në Kosovë, siç janë: njehsorët elektrikë,

mjetet matëse të masës (peshoret dhe gramarët), termometrat, volumetrat në pikat shitëse të karburanteve, si dhe kryen kontrollimin e cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara. Në kuadër të përgatitjes së mjeteve matëse për verifikim, testim dhe kalibrim, AMK ka autorizuar edhe subjekte, të cilat merren me servisimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim, testim apo kalibrim.

Misioni

- Të ruajë, të zhvillojë dhe të përdorë etalonët kombëtarë të njësive të matjeve;
- Të mbrojë konsumatorët nëpërmjet organizimit të kontrollit të instrumenteve matëse në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjen e shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, si dhe kontrollin sasior të para-paketimeve;
- Të ofrojë shërbime të kalibrimit prodhuesve dhe përdoruesve të mjeteve matëse për të qenë konkurrues në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Inspektorati i Tregut

Inspektorati i Tregut është organ ekzekutiv që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të 15 ligjeve dhe mbi 30 akte nënligjore të transpozuar nga Direktivat e qasjes së re dhe globale të Bashkimit Evropian.

Fushat të cilat i mbulon Inspektorati i Tregut janë: Tregtia e Brendshme, Mbrojtja e Konsumatorëve, Tregtimi me Naftë dhe Derivate të Naftës, Shërbimet Hoteliere dhe Turistike etj.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit:

- Është përgjegjës për hartimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorëve dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin e BE-së,
- Jep propozime për plotësimin dhe ndryshimin e rregullativës ligjore si dhe nxjerrjen e akteve tjera nën ligjore, që janë në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve.

- Pranon ankesat e konsumatorëve dhe kërkon nga mekanizmat që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut që të shqyrtojnë dhe të marrë masat e parapara me ligj.
- Bën studimin e funksionimit të tregut dhe rekomandon strukturat e MTI-së për marrjen e masave për funksionimin normal të tregut.

Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit


Këshilli është instrument i rëndësishëm për rregullimin e tregut, mbrojtjen e konsumatorit dhe evitimin e defekteve gjatë shkëmbimit të mallrave në raportin prodhues-tregtar-konsumator.

Këshilli është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për Mbrojtjen e Konsumatorëve, i cili përcakton politikat për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2010- 2014.

Programi Kosovar për Mbrojtjen e Konsumatorit

Tri objektivat kryesore, të specifikuar në Programin Kosovar për Mbrojtjen e Konsumatorit përfshijnë:

- Krijimin e bazës për zhvillimin e një tregu të sigurt, përfshirë këtu ngritjen e kapaciteteve administrative;
- Mbështetjen e iniciativave të shoqërisë civile për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Zhvillimin e sistemit të informimit dhe këshillimit të konsumatorëve.



Përfitimet nga Infrastruktura e Cilësisë

Rritja ekonomike - Kualiteti është parakusht për hyrje në treg. Si shtet, ne duhet të demonstrojmë që jemi në gjendje të prodhojmë produkte dhe shërbime të cilësisë së lartë. Ky demonstrim bëhet përmes një infrastrukture të cilësisë funksionale. Përfitimet që rezultojnë nga një infrastrukturë të cilësisë efikase janë: rritja e konkurrueshmërisë, inovacione më të mëdha, dhe shkallë më e lartë e transferit teknologjik, që ndikon në rritjen e kapacitetit të firmave vendore për tregti vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, duke kontribuar direkt në rritjen ekonomike.

Zhvillimi social - agjencitë rregulluese zbatojnë rregullore të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorit (për shembull, rregulloret që ndalojnë etiketimin dhe reklamimin fals apo çorientues). Aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të fokusuara në sigurimin e shëndetit dhe sigurisë çojnë vazhdimisht në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve. Bizneset mund t'i përdorin standardet që ofrojnë udhëzime se si ato mund të operojnë në një mënyrë të përgjegjshme sociale. Kjo nënkupton veprimin në mënyrë etike dhe transparente që do të kontribuonte në shëndetin dhe mirëqenien e shoqërisë.

Mbrojtja e ambientit – komponentët e Infrastrukturës së Cilësisë mund të shfrytëzohen në disa mënyra që të kontribuojnë në mbrojtjen e ambientit. Agjencia Kosovare për Standardizim ka adoptuar standarde evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit siç është SK EN ISO 14001: Sistemet e menaxhimit të mjedisit-Kërkesat me udhëzim për përdorimin e tij. SK EN ISO 14001 është në mesin e standardeve më të njohura. Si i tillë është implementuar nga 175 shtete dhe në rreth një milion kompani të ndryshme. Ky standard ndihmon kompanitë në minimizimin e efekteve të dëmshme në mjedis; konfirmon kërkesat e rregullatorit të mjedisit dhe përmirësimin e vazhdueshëm në performancë të mjedisit.



Nga perspektiva e rregullatorit, shumë rregullore teknike për ndotjen e ajrit dhe ujit, etj. u janë referuar Standardeve Kosovare, sepse vet standardet shpesh përdoren si bazë për hartimin e rregulloreve dhe mbështetjen në implementimin e tyre.

Kontakti

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Adresa:

Rr."Muharrem Fejza",p.n. Lagjja e Spitalit, 10000 - Prishtinë / Republika e Kosovës

www.mti-ks.org

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës

www.dak-ks.org

Agjencia Kosovare për Standardizim

www.aks.rks-gov.net

Inspektorati i Tregut

www.dit-ks.org

Për të lajmëruar lidhur me produktet për të cilat dyshoni ju mund të kontaktoni:

Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit në MTI:

0800 11 000

Nga të gjithë operatorët
pa pagesë.

